



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E DREJTA NDËRKOMBËTARE PRIVATE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Ndërkombëtare Private
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i 3-të, semestri i 6-të
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Ushtrime:
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka Asistent: Mr. Sc. Rilind Berisha
Detajet kontaktuese:	Email: dukagjin.leka@gmail.com & berisharilind@gmail.com Cel: +383 (0) 44 211 671
Përshkrimi i lëndës	Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimit gjatë semestrit dhe literaturën. Kuptimi, objekti dhe emërtimi i të DNP-së. Paraqitja dhe zhvillimi i të DNP-së. Zanafilla e të DNP-së në shtetet antike, Romë dhe Greqi. Teoria e statuteve. Shkolla italiane, franceze dhe holandeze-flamane. Burimet e të DNP-së. Burimet nacionale të së DNP-së. Burimet ndërkombëtare të së DNP-së. Konventa ndërkombëtare (bilaterale dhe multilaterale si burime të së DNP-së). Zakonet ndërkombëtare si burime të së DNP-së. Hierarkia e burimeve të së DNP-së. Raporti midis konventave ndërkombëtare dhe burimeve nacionale. Raporti midis burimeve të ndryshme nacionale të së DNP-së dhe zakonit ndërkombëtar. Zbrazëtirat juridike. Kodifikimi i të DNP-së. Kodifikimi i të DNP-së në planin nacional dhe ndërkombëtar. Metoda e kodifikimit ndërkombëtar të së DNP-së. Vendi i DNP-së

	në sistemin juridik të shteteve konkrete. Pikëpamjet sipas së cilave e DNP është pjesë e së drejtës ndërkombëtare. Pikëpamjet sipas së cilave e DNP është pjesë e së drejtës civile. Pikëpamjet sipas së cilave është degë e pavarur e sistemit juridik. Elementet e përgjithshme të formësimit të normës në të DNP. Elementi i huaj juridiko-privat (civil). Format e shprehjes së elementit të huaj juridiko-privat (format themelore dhe plotësuese). Roli dhe rëndësia e prezencës së elementit të huaj në marrëdhënien juridike-private. Faktet në bazë të të cilave krijohet elementi i huaj juridiko-privat (faktet e identifikimit). Faktet vendimtare (pikat e lidhjes). Shmangiet nga normat e së DNP-së (korreksioni i normave të kolizionit). Mënyrat juridike të rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj. Mënyra direkte dhe mënyra indirekte (e kolizionit) e rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj. Njohja, të provuarit dhe zbatimi i të drejtës së huaj. Sistemet për njohje dhe të provuarit e së drejtës së huaj. Njohja dhe të provuarit e së drejtës së huaj në shtetet me sistemet të përbëra juridike. Ndryshimi i të drejtës së huaj materiale që duhet të njihet dhe zbatohet nga organi i shtetit të vendit. Arsyet për njohjen dhe zbatimin e së drejtës së huaj materiale. Cilësimi (kualifikacioni), shfaqja dhe përkufizimi. Mënyrat e zgjidhjes së cilësimit (sipas lex fori, lex causae dhe sipas kuptimeve autonome). Çështja paraprake. Arsyet dhe kushtet për shtruarjen e çështjes paraprake (zgjidhjet në teori dhe praktikë. Faktet e identifikimit në subjekt. Shtetësia si fakt identifikimi. Mënyrat e fitimit të shtetësisë. Mënyrat krejsore dhe plotësuese të fitimit të shtetësisë. Mënyrat e humbjes së shtetësisë – për shkak të shprehjes së vullnetit të individit – për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të shtetasit ndaj shtetit. Efektet juridike të humbjes së shtetësisë. Reintegrimi. Kolizioni i shtetësive. Perosnat pa shtetësi dhe me disa shtetësi. Dëshmimi i shtetësisë. Shtetësia si fakt vendimtar. Shtetësia si fakt vendimtar për gëzimin e të drejtave statusore, për caktimin e zbatimit të së drejtës kompetente dhe për caktimin e kompetencës së gjykatës. Shmangiet nga shtetësia si fakt vendimtar. Shtetësia si fakt vendimtar të marrëdhëniet trashëgimore me element të huaj. Shtetësia si fakt vendimtar për gëzimin e të drejtave trashëgimore, zbatimit të së drejtës kompetente dhe caktimit të kompetencës së gjykatës. Vendbanimi si fakt identifikimi. Llojet e vendbanimit. Dëshmimi i vendbanimit. Vendbanimi si fakt vendimtar primar dhe subsidiar. Vendbanimi si faktvendimtar subsidiar për gëzime të drejtave civile nga të huajt, për caktimin e të drejtës kompetente dhe
--	--

	caktimin e kompetencës së gjykatës. Vendqëndrimi i rregullt dhe vendqëndrimi. Përkatësia e personave juridik si fakt identifikimi. Personat juridik që e kanë përkatësinë e një shteti dhe personat juridikë ndërkombëtar. Përkatësia e personave juridik si fakt vendimtar – për gëzimin e të drejtave civile, caktimin e kompetencës së gjykatës dhe caktimin e të drejtës kompetente. Faktet e identifikimit në objekt. Vendi ku gjendet sendi si fakt identifikimi dhe përkatësia e mjeteve themelore të transportit. Faktet vendimtare në objekt të marrëdhëniet juridike-private me element të huaj. Vendi ku gjendet sendi si fakt vendimtar për gëzimin e së drejtës civile nga të huajt, për caktimin e kompetencës së gjykatës dhe për caktimin e të drejtës kompetente (te sendet e paluajtëshme, te sendet e luajtëshme dhe të sendet në tranzit). Përkatësia e mjeteve themelore të transportit si fakt vendimtar për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt, për caktimin e kompetencës së gjykatës dhe për zbatimin e të drejtës kompetente. Faktet vendimtare të marrëdhëniet detyrimore me element të huaj. Faktet vendimtare për rregullimin e marrëdhënieve kontraktuese me element të huaj. Autonomia e vullnetit të palëve (roli, rëndësia dhe kufinj të zbatimit). Autonomia e vullnetit të palëve si fakt vendimtar për caktimin e të drejtës kompetente. Autonomia e vullnetit të palëve dhe dispozitat imperative. Llojet autonomisë së vullnetit të palëve. Kufizimi i autonomisë dhe afati (koha) deri kur palët kanë të drejtë ta shfrytëzojnë autonominë e vullnetit. Kufizimi i autonomisë së vullnetit të palëve të copëzimi i kontratës. Baza juridike e autonomisë dhe përjashtimi i saj të disa marrëdhënie kontraktuese me element të huaj. Autonomia e vullnetit të palëve si fakt vendimtar për caktimin e kompetencës së gjykatës. Faktet vendimtare për rregullimin e përmbajtjes së marrëdhënieve kontraktuese me element të huaj në mungesë të autonomisë. Vendi i lidhjes dhe i përmbushjes së kontratës. Vendbanimi ose selia e debitorit karakteristik. Lidhshmëria më e afërt dhe faktet tjera vendimtare. Faktet vendimtare për rregullimin e formës së marrëdhënieve detyrimore me element të huaj. Përjashtimi dhe detyrueshmëria e zbatimit të rregullës locus regit actum. Faktet vendimtare të përgjegjësitë jashtëkontraktuese (deliktet) me element të huaj. Parimi lex loci delicti commissi. Lex fori si parim plotësues. Shmangiet nga normat kompetente të së DNP-së (korrektimi i normave të kolizionit). Shmangiet që zbatohen të gjitha tërësitë që e sajojnë të DNP-në. Rendi publik ndërkombëtar. Shfaqja, përkufizimi dhe emërtimi i rendit publik. Karakteri nacional, roli dhe pasojat e zbatimit të rendit publik. Bishtërimi i ligjit. Kuptimi
--	--

	dhe elementet e bishtërimit të ligjit. Qëndrimet e ndryshme për zbatimin e bishtërimit të ligjit dhe pasojat juridike. Shmangiet që zbatohen te disa tërësi të DNP-së. Ridërgimi (paraqitja, elementet dhe arsyet për zbatimin e ridërgimit). Qëndrimet e ndryshme në të drejtën pozitive për ridërgimin. Reciprociteti. Kuptimi, natyra juridike dhe lëmenjtë e zbatimit të reciprocitetit. Llojet e reciprocitetit. Retorsioni. Kuptimi dhe lëmenjtë e zbatimit të retorsionit. Koncepcionet për objektin e pjesës së veçantë të së DNP-së. Cilësitë e elenit të huaj juridiko-privat të rënëdhësishme për pjesën e posaçme të së DNP-së. Të drejtat civile të huajve dhe kategorizimi i tyre sipas mundësisë së ushtrimit (gëzimit). Zhvillimi historik i të drejteve civile të huajve (koha antike, mesjeta dhe koha e re). Të drejtat civile të personave të huaj fizik. Të drejtat civile të huajve që krijohen me pjesëmarrjen e organit të shtetit. E drejta e të huajt të krijoj marrëdhënie familjare (martesa, adoptimi, legjitimimi, kujdestaria). E drejta e të huajt të jetë subjekt i marrëdhënieve juridike-sendore që kanë për objekt sendet e paluajtëshme sendet e luajtëshme. Të drejtat e të huajve që të jenë subjekt të marrëdhënieve trashëgimore (të disponoj me pasurinë në rast vdekjeje, të jetë trashigimtar). Të drejtat civile të huajve që krijohen pa pjesëmarrje të organit të shtetit (të drejtat detyrimore, të drejtat juridiko-sendore që kanë për objekt sendet e luajtëshme). Të drejtat civile të personave juridik të huaj. Kur i njihet personit juridik të huaj cilësia e personit juridik. Shteti si subjekt i marrëdhënieve juridike-pronësore. Të drejtat civile të personit juridik të huaj dhe të drejtat civile të personit fizik të huaj. E drejta e personit juridik të huaj të jetë subjekt i marrëdhënieve trashëgimore, pronësisë intelektuale. E drejta e personit juridik të huaj të ushtroj veprimtari në shtetin e vendit. Të drejtat civile të shtetasve të vendit që të krijojnë marrëdhënie juridike-private me element të huaj. Shfaqja e elementit të huaj në objekt të marrëdhënieve juridike-private. Llojet e të drejtave civile të shtetasve të vendit (statusore, kontraktuese). E drejta e të huajt që të paraqitet para gjykatave të shtetit të vendit. Ndihma juridike në komunikimin ndërkombëtar. Objekti dhe baza e ndihmës juridike. Mënyrat e komunikimit të ndihma juridike. Procedura te ndihma juridike. Rregullimi ndërkombëtar i ndihmës juridike. Konflikti (kolizioni) i jurisdiksioneve. Njohja e fuqisë argumentuese të dokumenteve të huaja publike. Legalizimi i dokumenteve në komunikimin ndërkombëtar juridiko-privat. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore. Sisteme për njohje dhe ekzekutim të vendimeve të huaja gjyqësore. Arbitrazhet
--	---

	e tregtisë së jashtme. Kuptimi, llojet dhe rëndësia. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit. Sistemet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit. Kushtet për njohje të vendimeve të huaja të arbitrazhit sipas burimeve nacionale. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit sipas traktateve ndërkombëtare. Konflikti (kolizioni) i ligjeve. Nocioni dhe elementet. Funkzioni i kolizionit të ligjeve. Kolizioni interlokal i ligjeve. Konflikti i ligjeve te disa kategori të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj që krijohen me pjesëmarrje të organit të sovranitetit. Kolizioni i ligjeve te raportet statusore me element të huaj te të cilët ndryshohet statusi i dy e më tepër personave. Martesa me element të huaj. Kushtet materiale për lidhjen e martesës me element të huaj. Forma e martesës me element të huaj. Forma e martesës diplomatiko-konzulare. Nuliteti i martesës me element të huaj. Ndarja e martesës me element të huaj. Adoptimi me element të huaj. Legjitimimi me element të huaj. Kujdestaria me element të huaj. Kolizioni i ligjeve te disa kategori të raporteve juridiko-private që krijohen pa pjesëmarrje të organit të sovranitetit të shtetit. Kontratat me element të huaj te të cilat autonomia e vullnetit të palësve është përjashtuar pjesërisht. Kontratat për punë me element të huaj. Kontrata mbi sigurimin me element të huaj. Kolizioni i ligjeve te kambiali dhe çeku me element të huaj. Kolizioni i ligjeve te deliktet me element të huaj.
Qëllimet e lëndës:	Duke pasur parasysh zhvillimin dhe intensifikimin e marrëdhënieve juridike me element të huaj, të cilat marrëdhënie hyjnë në kuadër të së Drejtës Ndërkombëtare Private, si dhe rolin që kjo e drejtë ka në konstelacionin juridik-privat, si dhe duke e ditur faktin se sot shumica e Universiteteve të njohura ndërkombëtare në botë kanë lëndën E Drejta Ndërkombëtare Private si lëndë të veçantë, edhe ne si Fakultet Juridik i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan e kemi parë mëse të nevojshme që kjo lëndë të futet në kurrikulën mësimore të Fakultetit Juridik, Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan. Në kuadër të DNP do të përfitohen njouri themelore nga lëmia e doktrinës juridike dhe të drejtës pozitive ndërkombëtare private; Pastaj në këtë kuadër do të paraqiten edhe aspekti i burimeve nacionale dhe ndërkombetare, dhe institucioneve kryesore të së drejtës ndërkombetare private; Si pjesë tjetër me rëndësi në kuadër të DNP do të jetë edhe shtjellimi i mënyrave të rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj, njohjen dhe të provuarit e të drejtës së

	huaj, elementeve të normës dhe tërësive që e sajajnë të drejtën ndërkombëtare private, etj. Poashtu në kuadër të DNP-së do të identifikohen dhe do të shihet se si zbatohen parimet, rregullat e të drejtës pozitive të sistemit juridik konkret nga lëmia e të drejtës ndërkombëtare private, si dhe të drejtat e sistemeve tjera juridike tek të cilat dërgon norma e kolizionit e sistemit juridik të shtetit të vendit; Pastaj do të identifikohen problemet (çështjet) juridike-private me element të huaj nga lëmia e marrëdhënieve statusore, juridike-sendore, trashëgimore, detyrimore, nga pronësia intelektuale dhe ofrimi i zgjidhjeve juridike për raste të ndryshme. Do të identifikon, interpreton, analizon dhe zgjidh probleme juridike nga lëmia e marrëdhënieve juridike-private me element te huaj, ashtu siç do të pritej nga një jurist i ri; Do të interpreton dhe arsyeton aplikimin e dispozitave juridike nga lëmia e të drejtës ndërkombëtare private në korelacion me sistemet juridike pozitive të shteteve tjera tek të cilat dërgon norma e kolizionit për zgjidhjen e situatave që shfaqen në jetën e përditshme; Do të komunikon me sukses dhe në mënyrë efektive, me shkrim dhe me gojë me subjektet (e së drejtës) nga lëmia publike dhe private; Do të zhvillon dhe avanson një sistem të mësimin që ngërthen në vehte identifikimin, klasifikimin, sistematizimin dhe aplikimin e burimeve të ndryshme nga lemitë gjegjëse të së drejtës ndërkombëtare private; Do të ketë aftësi për ta shfrytëzuar literaturën (bibliotekën) për perfeksionim të mëtutjeshëm, që të fitoj njohuri të reja, si në aspektin e doktrinës juridike, ashtu edhe të drejtes pozitive në aspektin nacional dhe ndërkombëtar. Intensifikimi i marrëdhënieve juridike me element të huaj si për nga lloji ashtu edhe për nga përmbajtja imponon probleme të llojllojshme juridike, që në masë të madhe paraqiten rishtas dhe shtrohen në një formë dhe dimension të ri. Sidomos kohën e fundit me shpërbërjen e një numri të konsiderueshëm të shteteve dhe me krijimin e shteteve të reja krijohet një situatë e re, e cila kërkon zgjidhje të llojllojshme që do t'u përgjigjet interesave të subjekteve juridike, e gjithashtu këto marrëdhënie juridike-private (juridike-
--	---

	civile) që ngërthejnë me vehte element të huaj juridiko-privat do të jenë konform me parimet e bashkësisë ndërkombëtare. Lëvizja e njerëzve, mallrave, të hollave, krijimtarisë intelektuale dhe ideve, sot janë dukuri e rregullt, dhe karakteristikë e rëndësishme e botës bashkëkohore, e gjithësesi edhe e ardhmërisë. Në kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi, nuk ka lëmi juridike ku nuk shfaqet elementi i huaj. Kalimi, qëndrimi (deri në vendosje të përhershme) i të huajve në çdo shtet, përkatësisht qëndrimi i shtetasve të vendit jashtë shtetit, krijimi i marrëdhënieve juridike, ku si subjekte paraqiten personat që kanë qoftë shtetësi të shteteve të ndryshme, qoftë vendbanimin (domicil) në shtetet e ndryshme; qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve nga prodhuesi nëpërmjet faktorëve determinues të shërbimeve (p.sh. përfaqësimit, kontrollit të kualitetit, transportit, magazinimit, ngarkimit etj.) deri tek konsumatori, përkatësisht deri tek shfrytëzuesi i fundit, rritja në mënyrë enorme e pagesave ndërkombëtare, kredive me valuta të ndryshme, shfrytëzimi i krijimtarisë intelektuale, posaçërisht nëpërmes patentave knoë-hoë, përkthimi dhe ekranizimi, përkatësisht dramatizimi larg dhe jashtë kufijve të shteteve ku ato krijimtari intelektuale janë krijuar; propagimi i gjërë i ideve nëpërmjet të televizionit dhe rjetit të zhvilluar satelitor që sot gati e mbuloi në tërësi rruzullin tokësor me qëllim të ndikimit të botëkuptimeve politike dhe ideologjive të masave të gjëra - e gjithë kjo ngërthen në vehte element të huaj (ndërkombëtar) dhe krijon probleme të reja juridike që kërkojnë edhe zgjidhje të reja juridike. Për rregullimin e marrëdhënieve juridike-private me element të huaj patjetër duhet të merren parasysht tre indikator: Para së gjithash duhet të njihen normat materiale (substanciale) dhe ata kolizive me anën e të cilave rregullohen marrëdhëniet juridike-private me element të huaj. Më pastaj duhet të merren parasysht normat juridike-pozitive të karakterit nacional dhe ndërkombëtar. Pastaj, duhet të njihet praktika gjyqësore dhe ajo e arbitrazhit, e gjykatave dhe arbitrazhave nacionale dhe ndërkombëtare, ngase nëpërmes vendimeve të tyre konkretizohen rregullat juridike që aplikohen për rregullimin e marrëdhënieve juridike-private me element të huaj. Dhe më në fund duhet të njihen edhe qëndrimet teorike lidhur me rregullimin juridik të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj.
--	--

	Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që ti bëjë të mundur studentëve që të kuptojnë Emërtimin e lëndës (pse emrohet si e drejtë ndërkombëtare dhe pse private);		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të: Që të dallojnë marrëdhëniet juridike-private (civile) nga marrëdhëniet juridike-private (civile) me element të huaj (ndërkombëtar); Që të fitojnë njohuri mbi burimet juridike që do të duhet ti aplikojnë për rregullimin e marrëdhënieve juridike-private me element të huaj (burime nacionale dhe ndërkombëtare); Që të fitojnë njohuri për mënyrat e rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj (mënyra e drejtpërdrejtë dhe mënyra e kolizionit ose indirekte që është karakteristikë vetëm për të DNP); Që të fitojnë njohuri për elementet e përgjithshme dhe të përbashkëta për formësimin dhe aplikimin e normave të së DNP. Mbi elementin e huaj juridiko-privat si <i>differentia specifica</i> e së DNP, mbi faktet në bazë të cilave shfaqet elementi i huaj juridiko-privat (<i>faktet e identifikimit</i>), faktet vendimtare (<i>pikat e lidhjes</i>), dhe mbi shmangiet nga normat rëndom kompetente (<i>shmangiet nga faktet vendimtare</i>) të së DNP. Që të fitojnë njohuri për tërësitë juridike që e sajojnë të DNP, mbi të drejtat civile të shtetasve të huaj që në territorin e shtetit të vendit të krijojnë marrëdhënie juridike-private me element të huaj, të drejtat civile të shtetasve të vendit që të krijojnë marrëdhënie juridike-private me element të huaj, konfliktin e juridiksioneve (e drejta procedurale ndërkombëtare) dhe për konfliktin (kolizionin e ligjeve).		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	Javë	4
Ushtrime teorike/laboratorike	1	Javë	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	Javë	2
Kollokfiume,seminare	2 Kollokfiume 1 Punim për	Javë	3

	Studentë		
Detyra të shtëpisë	10	Javë	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)			
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	Me kalimin e kohës, metodat akademike ndryshojnë dhe përparojnë. Përqendrimi në mendimin kritik, analitik dhe kreativ do të jetë filozofia qendrore e organizimit dhe mbarëvajtjes së kësaj lënde. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet përmbajtjes së diskutimit dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve gjatë orëve të ligjëratave të kësaj lënde. Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në zbatimin e programit të kësaj lënde mbështetet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura. Studentët duhet të ballafaqohen me problemet e jetës së përditshme të hulumtimit dhe interpretimit, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse dhe të ligj-bërjes ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, me prioritet ndaj atyre që kanë ose mund të kenë një korrelacion më të përafërt me përvojat dhe nevojat në Kosovë. Me fjalë të tjera, nuk do të prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to. Do të bëhet, gjithashtu, përpjekje për një ekuilibrim të përhapjes së njohurisë mbi tiparet kryesore të sistemit institucional ndërkombëtar dhe nocioneve më të specializuara, ndonëse orientimi parësor do të jetë i motivuar nga filozofia udhëheqëse, në këtë rast njohuria bazë mund të përftohet lehtë si derivat i diskutimit të përqendruar në probleme të specializuara, përparësia e të cilës empirikisht qëndron në një shkallë më të lartë probabiliteti të ngritjes apo rritjes së aftësisë ose shkathtësisë dhe kapacitetit për të zotëruar nocione më specifike dhe për të vepruar në kontekste më praktike.		

	Pastaj metodat e tjera bashkëkohore, të cilat do të përdoren gjatë procesit të mësim-dhënies dhe mësim-nxënies do të jenë edhe metodat interaktive, përmes pyetjeve dhe përgjigjeve, ndarja në grupe të vogla diskutuese, përmes prezantimeve, punimeve seminarike, testeve provuese, pregaditjes së rasteve të ndryshme për studim, analizimi i rasteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si në aspektin e mbrendshëm, poashtu edhe në aspektin ndërkombëtar, etj.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 30 pikë Testi i dytë: 50 pikë Detyrat e shtëpisë: 10 pikë (1 detyra x 10 pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Totali: 100 pikë. Provimi përfundimtar: 100 pikë Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	➤ Asllan Bilalli, Hajredin Kuçi, E Drejta nderkombetare private, Prishtinë, 2013; ➤ Asllan Bilalli, Hajredin Kuçi, Kolizioni i Ligjeve (Konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve)
Literatura shtesë:	➤ Hajredin Kuçi, Asllan Bilalli, Zanafilla, zhvillimi historik dhe burimet e të Drejtës Ndërkombëtare Private, Prishtinë, 2006; ➤ Hajredin Kuçi, Asllan Bilalli, Kolizioni i ligjeve, Prishtinë, 2006; ➤ Asllan Bilalli, Arsyet për aplikimin e normës së kolizionit gjatë rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile me element ndërkombëtar dhe element të mbrendshëm (interlokal), E Drejta- Law, Nr. 1, 2004, Prishtinë; ➤ Asllan Bilalli, Marrëdhëniet juridiko-private me element të huaj dhe mënyrat e rregullimit të tyre, E Drejta-Law, Nr.1, 2005; ➤ Asllan Bilalli, Njohja, të provuarit dhe aplikimi i të drejtës së huaj, E Drejta-Law. Nr.2-4, 2005; ➤ Asllan Bilalli, Elementet e përgjithshme dhe të përbashkëta të formësimit të normës në të drejtën ndërkombëtare private për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile me element të huaj; E Drejta-Law, Nr. 2, 2004; ➤ Asllan Bilalli, Kolizioni i ligjeve të deliktet në komunikacionin rrugor, E Drejta-Law, Nr. 1, 1998; ➤ Asllan Bilalli, Zgjidhja e kontesteve afariste me arbitrazh tregtar nderkombetar, E drejta-Law, Nr, 1, 2013; ➤ Asllan Bilalli, Arsyet për ndarjen e pjesës së posacme nga pjesa

	e përgjithme e të Drejtës ndërkombëtare private, E Drejta-law, Nr. 2, 2013. ➤ Anton Beaumont, Private International Law, 1990. ➤ Cheshire, North and Fawcett, Private International Law, 1999. ➤ Dicey and Morris on the Conflict of Laws, f.I-II 2000. ➤ Castel, Canadian Conflict of Laws, 1994. ➤ Brilmayer, Conflict of Laws: Foundations and Future Directions, 1991. ➤ Brilmayer, Conflict of Laws, Boston 1995. ➤ Hay, Conflict of Laws, 1994. ➤ Hay, Weintraub, Borchers, Conflict of Laws, Cases and Materials, New York 2000. ➤ Scoles, Hay Borchers, Syemonidis, Conflict of Laws, 2000. ➤ Nygh, Conflict of Laws in Australia, Salem 1991. ➤ Sykes, Pryles, Australian Private International Law, Sydney 1991. ➤ Posch, European Private International Law, 1998. ➤ Harris, Cases and materials on International Law, 1998.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	HYRJE Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimi gjatë semestrit dhe literaturën. Kuptimi, objekti dhe emërtimi i të DNP-së. Paraqitja dhe zhvillimi i të DNP-së. Zanafilla e të DNP-së në shtetet antike, Romë dhe Greqi.
Java e dytë:	Teoria e statuteve. Shkolla italiane, franceze dhe holandezo-flamane. Burimet e të DNP-së. Burimet nacionale të së DNP-së. Burimet ndërkombëtare të së DNP-së. Konventa ndërkombëtare (bilaterale dhe multilaterale si burime të së DNP-së). Zakonet ndërkombëtare si burime të së DNP-së. Hierarkia e burimeve të së DNP-së. Raporti midis konventave ndërkombëtare dhe burimeve nacionale. Raporti midis burimeve të ndryshme nacionale të së DNP-së dhe zakonit ndërkombëtar. Zbrazëtirat juridike. Kodifikimi i të DNP-së. Kodifikimi i të DNP-së në planin nacional dhe ndërkombëtar. Metoda e kodifikimit ndërkombëtar të së DNP-së Vendi i DNP-së në sistemin juridik të shteteve konkrete. Pikëpamjet sipas së cilave e DNP është pjesë e së drejtës ndërkombëtare. Pikëpamjet sipas së cilave e DNP është pjesë e së drejtës civile. Pikëpamjet sipas së cilave është degë e pavarur e sistemit juridik.

Java e tretë:	Elementet e përgjithshme të formësimit të normës në të DNP. Elementi i huaj juridiko-privat (civil). Format e shprehjes së elementit të huaj juridiko-privat (format themelore dhe plotësuese). Roli dhe rëndësia e prezencës së elementit të huaj në marrëdhënien juridike-private. Faktet në bazë të të cilave krijohet elementi i huaj juridiko-privat (faktet e identifikimit). Faktet vendimtare (pikat e lidhjes). Shmangiet nga normat e së DNP-së (korreksioni i normave të kolizionit).
Java e katërt:	Mënyrat juridike të rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj. Mënyra direkte dhe mënyra indirekte (e kolizionit) e rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj. Njohja, të provuarit dhe zbatimi i të drejtës së huaj. Sistemet për njohje dhe të provuarit e së drejtës së huaj. Njohja dhe të provuarit e së drejtës së huaj në shtetet me sistemet të përbëra juridike. Ndryshimi i të drejtës së huaj materiale që duhet të njihet dhe zbatohet nga organi i shtetit të vendit. Arsytet për njohjen dhe zbatimin e së drejtës së huaj materiale. Cilësimi (kualifikacioni), shfaqja dhe përkufizimi. Mënyrat e zgjidhjes së cilësimit (sipas lex fori, lex causae dhe sipas kuptimeve autonome). Çështja paraprake. Arsytet dhe kushtet për shtruarjen e çështjes paraprake (zgjidhjet në teori dhe praktikë).
Java e pestë:	Faktet e identifikimit në subjekt. Shtetësia si fakt identifikimi. Mënyrat e fitimit të shtetësisë. Mënyrat krejsore dhe plotësuese të fitimit të shtetësisë. Mënyrat e humbjes së shtetësisë – për shkak të shprehjes së vullnetit të individit – për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të shtetasit ndaj shtetit. Efektet juridike të humbjes së shtetësisë. Reintegrimi. Kolizioni i shtetësive. Perosnat pa shtetësi dhe me disa shtetësi. Dëshmimi i shtetësisë. Shtetësia si fakt vendimtar. Shtetësia si fakt vendimtar për gëzimin e të drejtave statusore, për caktimin e zbatimit të së drejtës kompetente dhe për caktimin e kompetencës së gjykatës. Shmangiet nga shtetësia si fakt vendimtar. Shtetësia si fakt vendimtar të marrëdhëniet trashëgimore me element të huaj. Shtetësia si fakt vendimtar për gëzimin e të drejtave trashëgimore, zbatimit të së drejtës kompetente dhe caktimit të kompetencës së gjykatës.
Java e gjashtë:	TESTI MES-SEMESTRAL
Java e shtatë:	Vendbanimi si fakt identifikimi. Llojet e vendbanimit. Dëshmimi i vendbanimit. Vendbanimi si fakt vendimtar primar dhe subsidiar. Vendbanimi si faktvendimtar subsidiar

	për gëzimine të drejtave civile nga të huajt, për caktimin e të drejtës kompetente dhe caktimin e kompetencës së gjykatës. Vendqëndrimi i rregullt dhe vendqëndrimi. Përkatësia e perosnave juridik si fakt identifikimi. Perosnat juridik që e kanë përkatësinë e një shteti dhe personat juridikë ndërkombëtar. Përkatësia e personave juridik si fakt vendimtar – për gëzimin e të drejtave civile, caktimin e kompetencës së gjykatës dhe caktimin e të drejtës kompetente.
Java e tetë:	Faktet e identifikimit në objekt. Vendi ku gjendet sendi si fakt identifikimi dhe përkatësia e mjeteve themelore të transportit. Faktet vendimtare në objekt të marrëdhëniet juridike-private me element të huaj. Vendi ku gjendet sendi si fakt vendimtar për gëzimin e të drejtës civile nga të huajt, për caktimin e kompetencës së gjykatës dhe për caktimin e të drejtës kompetente (te sendet e paluajtëshme, te sendet e luajtëshme dhe të sendet në tranzit). Përkatësia e mjeteve themelore të transportit si fakt vendimtar për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt, për caktimin e kompetencës së gjykatës dhe për zbatimin e të drejtës kompetente.
Java e nëntë:	Faktet vendimtare të marrëdhëniet detyrimore me element të huaj. Faktet vendimtare për rregullimin e marrëdhënieve kontraktuese me element të huaj. Autonomia e vullnetit të palëve (roli, rëndësia dhe kufinj të zbatimit). Autonomia e vullnetit të palëve si fakt vendimtar prioritar për caktimin e të drejtës kompetente. Autonomia e vullnetit të palëve dhe dispozitat imperative. Llojet autonomisë së vullnetit të palëve. Kufizimi i autonomisë dhe afati (koha) deri kur palët kanë të drejtë ta shfrytëzojnë autonominë e vullnetit. Kufizimi i autonomisë së vullnetit të palëve të copëzimi i kontratës. Baza juridike e autonomisë dhe përjashtimi i saj të disa marrëdhënie kontraktuese me element të huaj. Autonomia e vullnetit të palëve si fakt vendimtar për caktimin e kompetencës së gjykatës. Faktet vendimtare për rregullimin e përmbajtjes së marrëdhënieve kontraktuese me element të huaj në mungesë të autonomisë. Vendi i lidhjes dhe i përmbushjes së kontratës. Vendbanimi ose selia e debitorit karakteristik. Lidhshmëria më e afërt dhe faktet tjera vendimtare. Faktet vendimtare për rregullimin e formës së marrëdhënieve detyrimore me element të huaj. Përjashtimi dhe detyrueshmëria e zbatimit të rregullës locus regit actum. Faktet vendimtare të përgjegjësitë jashtëkontraktuese (deliktet) me element të huaj. Parimi lex loci delicti commissi. Lex fori si parim plotësues.

Java e dhjetë:	Shmangiet nga normat kompetente të së DNP-së (korrektimi i normave të kolizionit). Shmangiet që zbatohen te të gjitha tërësitë që e sajojnë të DNP-në. Rendi publik ndërkombëtar. Shfaqja, përkufizimi dhe emërtimi i rendit publik. Karakteri nacional, roli dhe pasojat e zbatimit të rendit publik. Bishtërimi i ligjit. Kuptimi dhe elementet e bishtërimit të ligjit. Qëndrimet e ndryshme për zbatimin e bishtërimit të ligjit dhe pasojat juridike. Shmangiet që zbatohen te disa tërësi të DNP-së. Ridërgimi (paraqitja, elementet dhe arsyet për zbatimin e ridërgimit). Qëndrimet e ndryshme në të drejtën pozitive për ridërgimin. Reciprociteti. Kuptimi, natyra juridike dhe lëmenjtë e zbatimit të reciprocitetit. Llojet e reciprocitetit. Retorsioni. Kuptimi dhe lëmenjtë e zbatimit të retorsionit.
Java e njëmbëdhjetë:	Koncepcionet për objektin e pjesës së veçantë të së DNP-së. Cilësitë e elenitit të huaj juridiko-privat të rënëdhësishme për pjesën e posaçme të së DNP-së. Të drejtat civile të huajve dhe kategorizimi i tyre sipas mundësisë së ushtrimit (gëzimit). Zhvillimi historik i të drejteve civile të huajve (koha antike, mesjeta dhe koha e re). Të drejtat civile të personave të huaj fizik. Të drejtat civile të huajve që krijohen me pjesëmarrjen e organit të shtetit. E drejta e të huajt të krijoj marrëdhënie familjare (martesa, adoptimi, legjitimimi, kujdestaria). E drejta e të huajt të jetë subjekt i marrëdhënieve juridike-sendore që kanë për objekt sendet e paluajtëshme sendet e luajtëshme. Të drejtat e të huajve që të jenë subjekt të marrëdhënieve trashëgimore (të disponoj me pasurinë në rast vdekjeje, të jetë trashigimtar). Të drejtat civile të huajve që krijohen pa pjesëmarrje të organit të shtetit (të drejtat detyrimore, të drejtat juridiko-sendore që kanë për objekt sendet e luajtëshme). Të drejtat civile të personave juridik të huaj. Kur i njihet personit juridik të huaj cilësia e personit juridik. Shteti si subjekt i marrëdhënieve juridike-pronësore. Të drejtat civile të personit juridik të huaj dhe të drejtat civile të personit fizik të huaj. E drejta e personit juridik të huaj të jetë subjekt i marrëdhënieve trashëgimore, pronësisë intelektuale. E drejta e personit juridik të huaj të ushtroj veprimtari në shtetin e vendit. Të drejtat civile të shtetasve të vendit që të krijojnë marrëdhënie juridike-private me element të huaj. Shfaqja e elementit të huaj në objekt të marrëdhënieve juridike-private. Llojet e të drejtave civile të shtetasve të vendit (statusore, kontraktuese). E drejta e të huajt që të paraqitet para gjykatave të shtetit të

	vendit. Ndihma juridike në komunikimin ndërkombëtar. Objekti dhe baza e ndihmës juridike. Mënyrat e komunikimit të ndihma juridike. Procedura të ndihma juridike. Rregullimi ndërkombëtar i ndihmës juridike.
Java e dymbëdhjetë:	Konflikti (kolizioni) i jurisdiksioneve. Njohja e fuqisë argumentuese të dokumenteve të huaja publike. Legalizimi i dokumenteve në komunikimin ndërkombëtar juridiko-privat. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore. Sisteme për njohje dhe ekzekutim të vendimeve të huaja gjyqësore. Arbitrazhet e tregtisë së jashtme. Kuptimi, llojet dhe rëndësia. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit. Sistemet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit. Kushtet për njohje të vendimeve të huaja të arbitrazhit sipas burimeve nacionale. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit sipas traktateve ndërkombëtare.
Java e trembëdhjetë:	Konflikti (kolizioni) i ligjeve. Nocioni dhe elementet. Funksioni i kolizionit të ligjeve. Kolizioni interlokal i ligjeve. Konflikti i ligjeve të disa kategori të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj që krijohen me pjesëmarrje të organit të sovranitetit. Kolizioni i ligjeve të raportet statusore me element të huaj të cilët ndryshohet statusi i dy e më tepër personave. Martesa me element të huaj. Kushtet materiale për lidhjen e martesës me element të huaj. Forma e martesës me element të huaj. Forma e martesës diplomatiko-konzulare. Nuliteti i martesës me element të huaj. Ndarja e martesës me element të huaj. Adoptimi me element të huaj. Legjitimimi me element të huaj. Kujdestaria me element të huaj. Kolizioni i ligjeve të disa kategori të raporteve juridiko-private që krijohen pa pjesëmarrje të organit të sovranitetit të shtetit. Kontratat me element të huaj të cilat autonomia e vullnetit të palësve është përjashtuar pjesërisht. Kontratat për punë me element të huaj. Kontrata mbi sigurimin me element të huaj. Kolizioni i ligjeve të kambiali dhe çeku me element të huaj. Kolizioni i ligjeve të deliktet me element të huaj.
Java e katërbëdhjetë:	TESTI PËRFUNDIMTAR
Java e pesëmbëdhjetë:	PROVIMI PËRFUNDIMTAR

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: